



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Sh.II.nr.1355/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Erpower” Sh.P.K, me seli në Viti, rr. “2 Korriku”, kundër debitorit “Dardania Group” ShPK me seli në Gjilan. Rr.”Shaban dhe Sami Ukshini” p.n. duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1847/22, të datës 20.07.2023, me datën 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Erpower” Sh.P.K, me seli në Viti, rr. “2 Korriku”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1847/22 i datës 20.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1847/22, të datës 20.07.2023, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit “Dardania Group” sh.p.k, sa i përket pjesës së detyrimit në shumën prej 2,794.00€, në këtë pjesë Urdhri i Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa, P.nr.287/2022 i datës 18.03.2022, shfuqizohet. II. Refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit “Dardania Group” sh.p.k, sa i përket pjesës së mbetur të detyrimit në shumën 4,240.00 €, në këtë pjesë Urdhri i Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa, P.nr.287/2022 i datës 18.03.2022, mbetet në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori, duke theksuar se në propozimin për përmbaram është cekur saktë se obligimi i debitorit ndaj kreditorit ka qenë shuma prej 14,034.00€, nga e cila është paguar shuma prej 7,000.00€, dhe vlera e borxhit të papaguar është 7,034.00€. po ashtu në dispozitiv është kërkuar shuma e saktë dhe se vetëm në pjesën hyrëse të propozimit ka mbetur gabimisht e shkruar vlerë prej 4,240.00€, ndërsa shuma e saktë është detajuar në dispozitiv të propozimit. Kreditori i ankesë i propozon gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovoj ankesën dhe lëndën ta kthej në rivendosje, ose të aprovoj ankesën e kreditorit dhe të mbetet ne fuqi urdhri përmbaramor P.nr.287/22 dt.18.03.2022.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaramore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Erpower” Sh.P.K, me seli në Viti, rr. “2 Korriku”, me datën 16.03.2022, ka paraqitur propozim për përmbaram ndaj debitorit Dardania Group” ShPK me seli në Gjilan. Rr.”Shaban dhe Sami Ukshini” p.n., në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.86/2021 të datës 19.08.2021 për shumën e borxhit në vlerë prej 7,034.00€. Përmbaruesi privat Kushtrim Musa, në bazë të faturës së lartcekur ka lejuar urdhrin përmbaramor P.nr.287/22 të datës 18.03.2022, me të cilin është obliguar debitori që t’i paguaj kreditorit shumën prej 7,034.00€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e përpilimit të propozimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaramore.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbaramit debitori ka paraqitur prapësim me të cilën ka kërkuar që të anulohet urdhri për përmbaram, sepse borxhi nuk është real sipas faturës ngase nuk janë kryer punë 2,350.00€ dhe se borxhi real i mbetur është 4,784.00€. Kreditori asnjëherë nuk ka dhënë vërejtje lidhur me mos pagesën e faturave. I propozon gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi për përmbaram dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbaramore sipas propozimit për përmbaram.

Kreditori ne përgjigjen në prapësim thekson se debitori në prapësim ka pranuar se ka borxh, mirëpo i njëjti këtë prapësim e ka bërë vetëm që të shtyj përmbaramin. Përmbaruesi privat drejt

ka lejuar përmbarimin duke u mbështetur në dokumente të besueshme ngase fatura i ka të gjitha elementet e parapara për fillimin e procedurës përmbarimore sipas nenit 29 të LPP-së, i propozon gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit ndërsa urdhri përmbarimor të vërtetohet si i bazuar.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1847/22 të datës 20.07.2023, me të cilin në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Dardania Group” sh.p.k, sa i përket pjesës së detyrimit në shumën prej 2,794.00€, në këtë pjesë Urdhri i Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, P.nr.287/2022 i datës 18.03.2022, shfuqizohet, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Dardania Group” sh.p.k, sa i përket pjesës së mbetur të detyrimit në shumën 4,240.00 €, në këtë pjesë Urdhri i Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, P.nr.287/2022 i datës 18.03.2022, mbetet në fuqi. Në arsyetim të vendimit theksohet se gjykata ka vlerësuar se fatura nr.86/21 dt.19.08.2021 i përmban tiparet e dokumentit të besueshëm nga neni 29.3 te LPP-së. Gjykata referohet ne nenin 71 të LPP-së, duke aprovuar pjesërisht prapësimin pasi që dokumenti i besueshëm-fatura e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta është përmbushur pjesërisht nga debitori.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se urdhri përmbarimor duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori në vlerë prej 2,794.00€, ngase debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin e tij, duke mbetur borxh shumën prej 4,240.00€, të cilin fakt e ka konfirmuar edhe kreditori.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbarimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbarimore dhe/apo atyre të besueshme, nga ku rrjedhimisht vet kreditori në përgjigjen në prapësim e ka pranuar se borxhi i mbetur nga fatura është vlera 4,240.00€, prandaj edhe gjykata e shkallës së parë, bazuar në dokumentin e besueshëm – faturën e cila i përmban të gjitha elementet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së për të qenë dokument i besueshëm, dhe nga vet deklarimi i kreditorit se debitori e ka përmbushur pjesërisht obligimin dhe se vlera e mbetur e borxhit është 4,240.00€, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.sk.II.nr.1355/23 me datë 04.06.2024

Gjyqtari

Krenar Berisha